

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **OPŠTINA SEVERNA MITROVICA/ KOMUNA E MITROVICËS SË VERIUT**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **2026/647-26-4501-5-2-1**

Sa i përket tenderit për: **“Ndërtimi i degëzimit të rrugës Tanasko Raiq (përballë Fushës Sportive)” në Mitrovicën Veriore**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

ETEA SH.P.K.

(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Millosevë, Obiliq

(Adresa)

Obiliq

(Vendi)

049/396874

(Numri Telefonit)

15050

(Kodi postar)

N/A

(Numri i Faks-it)

Drilon Etemi

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

eteamshpk@gmail.com

(Adresa elektronike)



27.08.2026

(Data e parashtrimit të kërkesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

*Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

Avokat Qëndrim Arifi
(Emri i avokatit)


Rr. "Idriz Gjilani", Llamela 15, Kati 2, Nr. 213, Dardani, Prishtinë.
(Adresa e plotë)

+383 49 875 852
(Numri i Telefonit)

avokatura.ap@gmail.com
(Adresa elektronike)

27.08.2026
(Data e parashtrimt të ankesës)

N/A
(Numri i faks-it)


AVOKAT / LAWYER
Qëndrim Arifi
AVOKATURA ARIFI & PARTNERS SH.P.K.
(Nënshkrimi dhe vula)

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar "Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs të projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës", "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

Njoftimi për kontratë – 10.06.2026
Afati i fundit për dorëzimin e tenderëve – 13.07.2026
B58 – Njoftimi mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues – 13.08.2026
Kërkesë për Rishqyrtim 17.08.2026
Vendimi për refuzimin e Kërkesës për Rishqyrtim 21.08.2026.

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐

Jo ☒

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☒

Jo ☐

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

Po ☒

Jo ☐

Më 17.08.2026 OE "ETEA" SH.P.K. ka parashtruar Kërkesë për Rishqyrtim pranë Autoritetit Kontraktues, në pajtim me nenin 108/A të LPP-së. Nëpërmjet Vendimit të datës 21.08.2026, Autoriteti Kontraktues e ka refuzuar në tërësi këtë kërkesë, duke e lënë në fuqi Njoftimin mbi Vendimin e AK-së të datës 13.08.2026. Prandaj, brenda afatit ligjor prej dhjetë (10) ditësh të përcaktuar me nenin 109, paragrafi 2 të LPP-së, i drejtohem Organit Shqyrtues të Prokurimit me këtë ankesë.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënie të Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 1 i LPP-së
Neni 6 i LPP-së
Neni 7 i LPP-së
Neni 52 i LPP-së
Neni 59 i LPP-së
Neni 60 i LPP-së
Neni 4 i RrPP-së
Neni 19.11 i RrPP-së
Neni 27.3 i RrPP-së
Neni 38 i RrPP-së
Neni 40.6, 40.13, i RrPP-së
Neni 45.17, 45.18, i RrPP-së
Neni 62.2 i RrPP-së
Neni 48 i Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthejë tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë të rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuara për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Rrjedha e procedurës:

1. ETEAM SH.P.K. më datë 13.07.2026, në përputhje me Njoftimin për Kontratë të Autoritetit Kontraktues (tutje referuar si AK) Komuna e Mitrovicës së Veriut, ka dorëzuar ofertën e tij për aktivitetin e prokurimit me titull: **"Ndërtimi i degëzimit"**

të rrugës Tanasko Raiq (përballë Fushës Sportive)” në Mitrovicën Veriore, me numër të prokurimit: 2026/647-26-4501-5-2-1

2. Në po të njëjtën datë, AK ka publikuar Procesverbalin e Hapjes së Tenderëve, nga i cili rezulton se për këtë aktivitet të prokurimit janë pranuar tri oferta, ndërsa oferta e ETEAM SH.P.K. është oferta me çmimin më të lirë, konkretisht në vlerë totale prej 15,158.00 euro.
3. AK më 13.08.2026 ka publikuar Njoftimin mbi Vendimin e AK-së, me të cilin vendim AK rekomandon për kontratë Grupin e Operatorëve Ekonomik (tutje GOE) GEB SH.P.K. & HARST Group SH.P.K., me çmim të ofertës prej 17,140.40 euro.

Nr. i Prokurimit:	647	26	4	5	0	1	5	2	1
-------------------	-----	----	---	---	---	---	---	---	---

Nr.	Emri dhe adresa Operatorëve Ekonomik pjesëmarrës	Vlera totale e ofertave ²
1.	ETEA SH.P.K., Obiliq, 15050, Rruga e Llapit PN, Milloshevë	15,158.00 Euro
2.	Grup i Operatorëve Ekonomik GEB SH.P.K.; HARST Group SH.P.K., Brigada 123, pn Suharekë, 23000, Suharekë	17,140.40 Euro
3.	Rexha, Kroi i Bardhë Lam.A Nr. I Nr.107, 10000, PRISHTINË	17,449.00 Euro

Rezultati i aktivitetit të prokurimit:

Komuna e Mitrovicës Veriore shpërblen me kontratë Grup i Operatorëve Ekonomik GEB SH.P.K.; HARST Group SH.P.K., Brigada 123, pn Suharekë, 23000, Suharekë, në vlerë totale të ofertës 17,140.40 Euro (Shtatëmbëdhjetë mijë e njëqind e dyzet euro e dyzet cent).

4. Ndërsa ofertën tonë në mënyrë të padrejtë dhe të kundërligjshme AK e shpallë si të papërgjegjshme mbi këto arsye:

[Tenderi juaj] [Kërkesa e juaj për pjesëmarrje] është vlerësuar me kujdes sipas kushteve dhe kërkesave të dhëna në njoftimin e kontratës dhe në [dosjen e tenderit] [dokumentet parakualifikuese]. Me keqardhje ju njoftojmë se jeni eliminuar për shkak të arsyeve në vijim: [Tenderi i juaj] [Kërkesa e juaj për pjesëmarrje] është administrativisht i papërgjegjshëm:
ARSYETIM

1. Nuk ploteson kriterin lidhur me aftësinë profesionale për arsye: te Lista e Stafit Teknik të Kompanisë ka kontrata valide vetëm për 5 punëtorë, ndërsa një punëtor ka kontratën e skaduar me date 31.12.2025 dhe një punëtor pa kontratë fare dhe si e tillë nuk mund të llogaritet si dëshmi si dhe Gjeodeti i cili është tek Kapaciteti Teknik dhe Profesional është evidentuar edhe në listen e stafit Teknik të punëtorëve, ku nga këto rezulton se Operatori Ekonomik “ETEA” SH.P.K. ka ofruar vetëm 5 punëtorë Teknik nga 8 të kërkuar.

5. ETEAM SH.P.K. brenda afatit ligjor panë AK-së ka parashtruar Kërkesë për Rishqyrtim, ndërsa e njëjta nëpërmjet vendimit të datës 21.08.2026 është refuzuar në tërësi si e pabazuar.
6. ETEAM SH.P.K., i pakënaqur me këtë vendim të AK-së, brenda afateve ligjore pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit paraqet këtë ankesë. Andaj, në vazhdim po i parashtrojmë pretendimet tona ankimore:

Pretendimi 1: Vendimi i AK-së për refuzimin e Kërkesës për Rishqyrtim mbështetet në një premisë juridike të gabuar, aplikon standarde të dyfishta dhe nuk i trajton pretendimet e parashtruara

Para se t'i parashtrojmë pretendimet e njëjta të ngritura në Kërkesën për Rishqyrtim, të cilat mbeten në tërësi të pandryshuara, konsiderojmë të domosdoshme të trajtohet arsyetimi i Vendimit të AK-së të datës 21.08.2026, pasi i njëjti nuk i përgjigjet plotësisht pretendimeve tona dhe, në pjesën ku u përgjigjet, mbështetet në një interpretim të gabuar të dispozitave ligjore.

1. Qëndrimi i AK-së se neni 72 i LPP-së nuk mund të përdoret për dokumente që mungojnë është në kundërshtim me LPP-në dhe RrPP-në

Baza e vetme juridike mbi të cilën AK e refuzon pretendimin tonë të parë është konstatimi se: *“Neni 72 i LPP-së nuk mund të përdoret si mekanizëm për plotësimin e një kërkeje materiale të ofertës, por vetëm për sqarimin e informacionit të paraqitur, në kufijtë e lejuar nga legjislacioni dhe udhëzuesit përkatës.”*

Ky konstatim nuk gjen mbështetje as në tekstin e nenit 72 të LPP-së, as në Rregulloren për Prokurimin Publik dhe as në Udhëzuesin Nr. 002/2024 të KRPP-së, të cilin vetë AK e citon.

Neni 72, paragrafi 1 i LPP-së përcakton shprehimisht se: *“Kur informacioni apo dokumentacioni që duhet të dorëzohet nga operatorët ekonomikë është ose duket të jetë jo i plotë ose i gabuar, ose kur mungojnë dokumentet specifike, autoritetet kontraktuese mund të kërkojnë nga operatorët ekonomikë që të dorëzojnë, plotësojnë, sqarojnë apo kompletojnë informacionin apo dokumentacionin e duhur brenda një afati të caktuar kohor, me kusht që kërkesat e tilla bëhen në përputhje të plotë me parimet e trajtimit të barabartë dhe transparencës.”*

Pra, vetë dispozita e përmend shprehimisht rastin “kur mungojnë dokumentet specifike” dhe i lejon shprehimisht veprimet e “plotësimit” dhe të “kompletimit”. Dallimi që AK e ndërton mes “plotësimit” dhe “sqarimit” nuk ekziston në tekstin e ligjit dhe akteve nënligjore, përkundrazi, të dyja janë të përfshira në të njëjtin paragraf si veprime të lejuara.

Më tej, neni 72, paragrafi 2 i LPP-së parasheh se AK mund t'i ftojë operatorët ekonomikë *“për të plotësuar apo të qartësojë certifikatat dhe dokumentet e paraqitura në pajtim me nenet 65-71 të këtij ligji”*. Dëshmitë për stafin janë dëshmi të aftësisë teknike dhe/ose profesionale sipas nenit 69 të LPP-së, e cila bie pikërisht brenda dispozitave 65-71. Rrjedhimisht, dokumentacioni i stafit është shprehimisht objekt i mundësisë së plotësimit.

Kufiri i vërtetë ligjor i këtij mekanizmi është përcaktuar në nenin 72, paragrafi 3 të LPP-së: *“Sigurimi i informacionit që mungon ose ofrimi i informacionit do të aplikohet vetëm për dokumentet ekzistenca e të cilave është e fiksuar, para skadimit të afatit për dorëzimin e tenderëve, dhe mund të verifikohet në mënyrë objektive.”* Ky është kufizimi i vetëm ligjor, mirëpo për rastin tonë nuk mund të vlej sepse është e padiskutueshme se dokumentet kanë qenë të fiksuara para mbylljes së afatit për dorëzimin e tenderit.

Neni 38.3 i RrPP-së e konfirmon këtë edhe më drejtpërdrejt: *“Megjithatë, lejohet që një autoritet kontraktues gjatë vlerësimit të kërkojë dhe të marrë informacione apo dokumente, të cilat mungojnë në aplikacion/tender. Këto dokumente, megjithatë, në mënyrë objektive duhet të prezantojnë prova të mjaftueshme që në mënyrë të arsyeshme pasqyrojnë gjendjen ekzistuese para skadimit të afatit për dorëzimin e tenderëve.”*

Në të njëjtin drejtim, neni 38.5 i RrPP-së përsërit se AK mund t'i ftojë operatorët ekonomikë të plotësojnë apo qartësojnë dëshmitë e dorëzuara për aftësinë teknike dhe profesionale.

Duke e konsideruar veten të penguar ligjërisht për të vepruar sipas nenit 72 të LPP-së, AK në fakt nuk e ka ushtruar fare vlerësimin që ligji ia beson, por e ka mohuar ekzistencën e kompetencës duke eliminuar ofertën tonë padrejtësisht.

2. Argumenti i AK-së lidhur me ATK-në i përgjigjet një pretendimi që nuk është ngritur nga ne

AK konstaton se *“regjistrimi i personave në ATK nuk është vetvetiu i mjaftueshëm për të konstatuar përmbushjen e kriterit, nëse Dosja e Tenderit ka përcaktuar dokumente specifike për dëshmimin e stafit”*.

ETEAM SH.P.K. nuk ka pretenduar asnjëherë se Lista e ATK-së e zëvendëson dokumentin e kërkuar me Dosjen e Tenderit. Lista e ATK-së është paraqitur si mjet i verifikimit objektiv se ekzistenca e marrëdhënies së punës është e fiksuar para skadimit të afatit, në kuptim të nenit 72.3 të LPP-së dhe të nenit 38.3 të RrPP-së. Dokumenti i kërkuar me Dosje të Tenderit, përkatësisht kontrata e punës, ekziston, ka ekzistuar para afatit për dorëzimin e tenderit dhe AK është dashur që të kërkojë informata shtesë.

3. Brenda të njëjtit Vendim, AK ka aplikuar dy standarde juridike diametralisht të kundërta ndaj dy operatorëve ekonomikë

Duke iu përgjigjur pretendimit tonë lidhur me mosdëshmimin e posedimit të “Pompës së ujit 3hp, diesel” nga GOE i rekomanduar, AK konstaton: *“Në këtë drejtim, Komisioni ka zbatuar parimet e proporcionalitetit, ekonomikitetit dhe efikasitetit, duke mos e konsideruar mungesën e një formulimi të caktuar në një dokument financiar si bazë automatike për eliminimin e ofertës, përderisa nuk është konstatuar në mënyrë të qartë dhe objektive mungesa e kapacitetit të kërkuar.”*

Kjo i bije që:

- a) Për GOE-në e rekomanduar, një mangësi dokumentare nuk mund të jetë bazë automatike për eliminim, përderisa mungesa e kapacitetit nuk është konstatuar qartë dhe objektivisht, ndërsa
- b) Për ETEAM SH.P.K., një mangësi dokumentare është bazë e mjaftueshme dhe automatike për eliminim, edhe pse ekzistenca e kapacitetit është plotësisht e

verifikueshme objektivisht përmes Listës së të Punësuarve të ATK-së dhe kontratave të punës.

Parimet e proporcionalitetit, ekonomicitetit dhe efikasitetit nuk janë parime që zbatohen selektivisht. Ato janë parime themelore të prokurimit publik, të përcaktuara në nenin 6 të LPP-së dhe në nenin 4.3 të RrPP-së, të cilat, sipas nenit 40.1 të RrPP-së, e detyrojnë Komisionin Vlerësues në tërë procesin e ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve, pra ndaj të gjithë operatorëve ekonomikë njësoj.

Aplikimi i një standardi tolerues ndaj njërit operator dhe i një standardi rreptësisht formalist ndaj një operatori tjetër, brenda të njëjtit vlerësim dhe nga i njëjti Komision, përbën shkelje të drejtpërdrejtë të nenit 7, paragrafi 1 të LPP-së, si dhe të nenit 7, paragrafi 2, i cili ia ndalon AK-së çdo veprim që diskriminon në dëm ose në të mirë të një apo më shumë operatorëve ekonomikë. Po ashtu, neni 4.3, pika (c) e RrPP-së e obligon AK-në të veprojë drejt gjatë tërë ciklit të prokurimit, “pa imponuar obligime të panevojshme ose pengesa” dhe duke shmangur “çdo trajtim që favorizon një furnizues të caktuar”, ndërsa pika (e) e po të njëjtit paragraf e obligon AK-në të sigurojë kushte dhe qasje të barabartë për të gjithë operatorët ekonomikë.

4. AK nuk i është përgjigjur provës lidhur me trajtimin e ndryshëm në dy aktivitete të mëparshme të prokurimit

Në Kërkesën për Rishqyrtim ne kemi paraqitur si provë faktin se i njëjti Autoritet Kontraktues, për të njëjtën çështje të dokumentimit të stafit dhe ndaj të njëjtit operator ekonomik (ndaj ETEAM SH.P.K.), ka kërkuar sqarime në dy aktivitete të mëparshme të prokurimit: “Ndërtimi dhe rregullimi i degëzimit të rrugës Duka Mishiq”, me nr. 647-26-4780-5-2-1, dhe “Rregullimi i rrugës Nezir Zasella”, me nr. 647-26-4540-5-2-1. AK në vendimin për refuzimin e Kërkesës për Rishqyrtim fare nuk është marrë me këtë çështje. Dhe pas sqarimeve neve thjesht na ka shpallur të pasuksesshëm, duke vërtetuar se plotësojmë kërkesat e Dosjes së Tenderit lidhur me stafin.

5. AK nuk i është përgjigjur fare pretendimit lidhur me nenin 52.7 të LPP-së

Në Kërkesën për Rishqyrtim ne jemi thirrur shprehimisht në nenin 52, paragrafi 7 të LPP-së, i cili është dispozitë urdhëruese: “*Autoriteti kontraktues në rast të dyshimit të cilido informacioni të dorëzuar nga operatori ekonomik, do të kryejë një kontroll efektiv të informatave dhe dokumentacionit të tenderit.*” Në Vendimin e datës 21.08.2026, AK nuk e përmend fare këtë dispozitë, nuk deklaron se ka kryer ndonjë kontroll efektiv dhe nuk paraqet asnjë të dhënë se ka verifikuar angazhimin e stafit kyç të GOE-së.

6. Përgjigja e AK-së lidhur me pompën e ujit tregon haptas njëanshmëri ndaj GOE-së së rekomanduar

AK konstaton se dokumentacioni i GOE-së e identifikon pajisjen përmes modelit GWP302 dhe dimensionit 80 mm, dhe se mungesa e përsëritjes së plotë të specifikimit “3 HP, diesel” nuk mund të konsiderohet, në vetvete, dëshmi e mjaftueshme se kërkesa nuk është përmbushur. Kjo qasje e AK-së është haptas njëanshmëri ndaj GOE-së së rekomanduar,

duke e justifikuar kundërligjshëm një kërkesë të pa përmbushur, përderisa sipas nenit 40.6 të RrPP-së, tenderi konsiderohet i përgjegjshëm kur është në pajtueshmëri me kërkesat dhe specifikimet e dosjes së tenderit.

Përtej kësaj, në një aktivitet tjetër të prokurimit të inicuar nga AK Komuna e Mitrovicës së Veriut, me titull: *“Ndertimi i rruges, parkingut dhe krijimi i sipërfaqeve të gjelberuara në rrugën Vasilije Ostrovski” në Mitrovicën Veriore*” me nr. të prokurimit: "647-26-2891-5-2-1", ekspertja shqyrtuese lidhur me pretendimin tonë të ngjashëm, përkatësisht specifikën “3HP, diesel” të cilën AK e konsideronte të parëndësishme, ka rekomanduar që AK duhet të kërkojë sqarime shtesë lidhur me këtë çështje.

PROVË: Shih raportin e ekspertizës në lëndën 2026/0491.

7. Vendimi refuzues nuk përmbush standardin ligjor të arsyetimit

Neni 62.2 i RrPP-së përcakton se *“Vendimi mbi refuzimin do të arsyetohet dhe do të publikohet në sistem të prokurimit elektronik nga Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit”*. Ky detyrim nuk plotësohet me përsëritjen e konkluzionit të vendimit fillestar. Neni 48, paragrafi 1 i LPPA-së kërkon që arsyetimi të përmbajë, ndër të tjera, shkaqet të cilat kanë qenë vendimtare gjatë vlerësimit të provave dhe shkaqet për të cilat nuk është pranuar ndonjëri nga pretendimet e palëve, ndërsa paragrafi 2 i po këtij neni përcakton se *“Një arsyetim që është dukshëm i pamjaftueshëm, i paqartë, kundërthënës apo i pakuptueshëm, është i barabartë me mungesën e tij”*.

Andaj Vendimi i AK-së i datës 21.08.2026 vlerësojmë se është i kundërligjshëm dhe nga Organi Shqyrtues i Prokurimit duhet të anulohet.

Ashtu siç u potencua më lartë, pretendimet tona ankimore të paraqitura nëpërmjet Kërkesës për Rishqyrtim mbasin të pandryshuara dhe të njëjtat po i paraqesim në vazhdim.

Pretendimi 2: ETEAM SH.P.K. e përmbush plotësisht kërkesën lidhur me kapacitetin teknik dhe profesional, ndërsa për çdo paqartësi eventuale AK ka pasur mundësi dhe bazë ligjore të kërkojë sqarime shtesë

AK, nëpërmjet Njoftimit mbi Vendimin e AK-së të datës 13.08.2026, pretendon se ETEAM SH.P.K. nuk e përmbush kriterin lidhur me kapacitetin teknik dhe profesional, me arsyetimin se: *“Te Lista e Stafit Teknik të Kompanisë ka kontrata valide vetëm për 5 punëtorë, ndërsa një punëtor ka kontratën e skaduar me datë 31.12.2025 dhe një punëtor pa kontratë fare dhe si e tillë nuk mund të llogaritet si dëshmi, si dhe Gjeodeti i cili është tek Kapaciteti Teknik dhe Profesional është evidentuar edhe në listën e stafit Teknik të punëtorëve, ku nga këto rezulton se Operatori Ekonomik ‘ETeam’ SH.P.K. ka ofruar vetëm 5 punëtorë Teknik nga 8 të kërkuar”*.

Ky arsyetim i AK-së është tërësisht i paqëndrueshëm dhe nuk pasqyron gjendjen reale të dokumentacionit të dorëzuar nga ETEAM SH.P.K., për faktin se ETEAM SH.P.K. e ka përmbushur në tërësi kërkesën e përcaktuar në Dosjen e Tenderit lidhur me numrin e stafit teknik. Në këtë rast, nuk kemi të bëjmë me mungesë reale të kapacitetit teknik të kërkuar nga AK-ja, por me një çështje që lidhet me mënyrën e dokumentimit të këtij kapaciteti dhe

me disa paqartësi të cilat kanë mundur të verifikohen dhe të sqarohen nga AK-ja nëpërmjet kërkesës për sqarime shitesë të paraparë me nenin 72 të LPP-së.

Sipas kërkesave të Dosjes së Tenderit, operatori ekonomik është dashur të disponojë me minimum tetë (8) punëtorë teknikë, ndërsa veçmas janë kërkuar edhe tre (3) inxhinierë si staf profesional. Me rastin e dorëzimit të ofertës, ETEAM SH.P.K. ka konsideruar se staf profesional i propozuar, përkatësisht tre inxhinierët, të cilët njëkohësisht janë pjesë e stafit të punësuar të kompanisë, përmbushin një pjesë të kërkesës së përgjithshme për stafin e nevojshëm për realizimin e kontratës. Për këtë arsye, krahas Listës së stafit janë bashkëngjitur kontratat përkatëse të punës që, sipas vlerësimit tonë në momentin e dorëzimit të ofertës, ishin të mjaftueshme për të dëshmuar përmbushjen e kërkesës së AK-së.

Pra, çështja në këtë rast nuk ka të bëjë me mos ekzistencën e stafit në momentin e ofertimit për tender, por vetëm me faktin se disa nga kontratat përkatëse nuk janë bashkëngjitur në ofertë si dhe në një rast është bashkëngjitur kontrata e një periudhe të mëparshme. Ky dallim është jashtëzakonisht i rëndësishëm, sepse nuk mund të barazohet mungesa e një dokumenti me mungesën e kapacitetit që ai dokument e dëshmon, sidomos kur ekzistenca e këtij kapaciteti mund të verifikohet në mënyrë objektive përmes dokumenteve të ATK-së dhe dokumenteve të tjera relevante. ETEAM SH.P.K. së bashku me ofertë ka bashkëngjitur listën e stafit të deklaruar në ATK, listë kjo e përbërë prej nëntë (9) të punësuarve:



Republika e Kosovës - Republika Kosova - Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Financave - Ministarstvo za Finansije - Ministry of Finance

Administrata Tatimore e Kosovës - Poreska Administracija Kosovo - Tax Administration of Kosovo



Lista e Punëtorëve

Periudha

2026

Numri Fiskal	812112647	Kontakti	DRILON ETEMI
Tatimpaguesi	ETEAM SH.P.K.	Adresa	Rr. Llap, , p.n.
Regjioni	PRISHTINË 2	Tel	+38349396874
Lloji Kompanisë	SH.P.K.	Aktiviteti	Prodhimi i betonit të përzier, i gatshëm për përdorim

Nr.	Emri	Nr. Përsional	Primare	MUJAT											
				1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12
1	ARGJEND DOBRATIQI	1247617198	PO	+	+	+	-	-	-	-	-	-	-	-	-
2	BASTRI RAMA	1172189233	PO	+	+	+	-	-	-	-	-	-	-	-	-
3	DRILON ETEMI	2912082078	PO	+	+	+	-	-	-	-	-	-	-	-	-
4	EMINE ARIFI	1240383167	PO	+	+	+	-	-	-	-	-	-	-	-	-
5	HALIL HALILI	1249627735	PO	+	+	+	-	-	-	-	-	-	-	-	-
6	LAVDIM HASANI	1243839021	PO	+	+	+	-	-	-	-	-	-	-	-	-
5/9/2026 10:24:05 AM															
7	MIRJETA KRIVAQA ETEMI	1241551047	PO	+	+	+	-	-	-	-	-	-	-	-	-
8	NEHAT MAXHUNI	1004763595	JO	+	+	+	-	-	-	-	-	-	-	-	-
9	REMZI RAMADANI	1176639713	PO	+	+	+	-	-	-	-	-	-	-	-	-

Lista e punëtorëve të deklaruar në ATK e vitit 2026 (e bashkëngjitur me ofertë)

Sa i përket stafit teknik **z. Bastri Rama**, për të cilin AK pretendon se ka kontratë të skaduar, bëhet fjalë për një lëshim teknik gjatë përgatitjes së ofertës, pasi në vend të kontratës valide të vitit 2026 është bashkëngjitur kontrata e vitit 2025. ETEAM SH.P.K., me këtë Kërkesë për Rishqyrtim, po e bashkëngjisim edhe kontratën valide të punës së z. Bastri Rama. Fakti se kjo marrëdhënie pune ka ekzistuar para dorëzimit të ofertës, dëshmohet qartësisht nga Lista e të Punësuarve të ATK-së, ku z. Bastri Rama figuron si i punësuar dhe i deklaruar nga ETEAM SH.P.K. para afatit të fundit për dorëzimin e ofertave. Prandaj, kontrata e punës e bashkëngjitur në ofertë është e vitit 2025 dhe ka qenë një gabim teknik në përzgjedhjen e dokumentit dhe jo dëshmi se z. Bastri Rama nuk ka qenë pjesë e stafit të ETEAM SH.P.K. në momentin e dorëzimit të ofertës.

Sa i përket stafit teknik **z. Nehat Maxhuni**, edhe në këtë rast, përmes Listës së të Punësuarve të ATK-së është më se e qartë se i njëjti ka qenë i deklaruar si punëtor i ETEAM SH.P.K., para afatit të fundit për dorëzimin e ofertës. ETEAM SH.P.K. ka kontratë valide të punës me z. Nehat Maxhuni, të cilën gjithashtu e kemi bashkëngjitur në Kërkesë për Rishqyrtim dhe po e bashkëngjisim edhe në këtë ankesë. Mos dorëzimi i kësaj kontrate në ofertë ka ardhur si rezultat i bindjes sonë se kërkesa lidhur me numrin e stafit teknik ishte tashmë e përmbushur përmes stafit të paraqitur dhe dokumentacionit të dorëzuar, dhe për këtë arsye nuk është konsideruar e nevojshme që të bashkëngjitej edhe kontrata e z. Maxhuni. Megjithatë, vetë fakti që ky punëtor ka qenë i deklaruar në ATK para dorëzimit të ofertës dëshmon se nuk bëhet fjalë për një person të angazhuar pas afatit të ofertimit, por për një punëtor që ka qenë pjesë e stafit të ETEAM SH.P.K. para afatit të fundit për dorëzimin e ofertave.

Pikërisht për këtë arsye, në këtë rast janë plotësuar kushtet që AK, nëse ka konsideruar se ekziston ndonjë paqartësi lidhur me dokumentacionin e stafit, të aplikojë nenin 72 të LPP-së dhe të kërkojë sqarime apo dokumentacion shtesë nga ETEAM SH.P.K. Neni 72 i LPP-së i jep AK-së mundësinë që, kur informacioni ose dokumentacioni është ose duket të jetë i paplotë, i pasaktë apo kur mungojnë dokumente specifike, të kërkojë nga operatori ekonomik që të dorëzojë, plotësojë, sqarojë ose kompletojë informacionin dhe dokumentacionin përkatës. Në rastin konkret, ekzistenca e dokumenteve dhe marrëdhënieve të punës është e fiksuar para skadimit të afatit për dorëzimin e tenderëve dhe mund të verifikohet në mënyrë objektive përmes Listës së të Punësuarve të ATK-së dhe kontratave të punës.

Për qëllime të sqarimit dhe të vërtetimit se ETEAM SH.P.K. ka qenë dhe është OE plotësisht i përgjegjshëm, si dhe se në këtë rast nuk kemi të bëjmë me krijimin e ndonjë kapaciteti të ri pas dorëzimit të ofertës, por vetëm me dokumentimin dhe verifikimin e një gjendjeje faktike që ka ekzistuar para dorëzimit të ofertës, ne me këtë ankesë ashtu si edhe me Kërkesë për Rishqyrtim po bashkëngjisim të gjitha kontratat e punës të punëtorëve të evidentuar në Listën e të Punësuarve të ATK-së, të cilët kanë qenë të punësuar në ETEAM SH.P.K. në momentin e dorëzimit të ofertës. Nga ky dokumentacion dëshmohet qartë se ETEAM SH.P.K. ka përmbushur kërkesën e AK-së për së paku tetë (8) punëtorë teknikë. Pra, përjashtuar z. Ragip Behrami, z. Safet Lipovica dhe z. Drilon Etemi, ETEAM SH.P.K. ka në dispozicion edhe tetë (8) punëtorë të cilët kanë qenë të punësuar para afatit të fundit për dorëzimin e ofertës dhe të cilët mund të dëshmohen me dokumentacion përkatës. (sqarim i tërë ky dokumentacion ka qenë i bashkëngjitur edhe me Kërkesë për Rishqyrtim).

PROVË: Lista e të Punësuarve të ETEAM SH.P.K. e gjenruar nga ATK dhe kontratat e punës për stafin e evidentuar në këtë listë.

Në këtë rast është me rëndësi të theksohet se dokumentacioni i cili po bashkëngjitet me këtë Ankesë nuk synon të ndryshojë ofertën e dorëzuar nga ETEAM SH.P.K., nuk ndryshon përmbajtjen teknike të saj dhe as nuk krijon ndonjë kapacitet të ri pas skadimit të afatit për dorëzimin e ofertave. Përkundrazi, ky dokumentacion vetëm e qartëson dhe e dëshmon një gjendje faktike e cila ka ekzistuar para dorëzimit të ofertës. Pikërisht për këtë arsye, AK ka pasur bazë ligjore që, nëse ka pasur paqartësi lidhur me dokumentacionin, të kërkojë sqarime në pajtim me nenin 72 të LPP-së.

Është tejet e rëndësishme të theksohet se ETEAM SH.P.K. nuk po kërkon që AK të lejojë një plotësim që do të ndryshonte përmbajtjen materiale të ofertës. Përkundrazi, ETEAM SH.P.K. po kërkon vetëm që AK të vlerësojë dokumentet që dëshmojnë një fakt ekzistues dhe të verifikueshëm, përkatësisht faktin se në momentin e dorëzimit të ofertës kompania ka pasur në dispozicion numrin e kërkuar të punëtorëve. Nëse një fakt i tillë ka ekzistuar para afatit dhe mund të verifikohet objektivisht, elimini i operatorit ekonomik vetëm për shkak të një mangësie apo paqartësie dokumentare, pa u përdorur mekanizmi i sqarimit, nuk mund të konsiderohet qasje e drejtë dhe proporcionale në vlerësimin e ofertës.

Kjo çështje bëhet edhe më e rëndësishme duke pasur parasysh se oferta e ETEAM SH.P.K. është oferta me çmimin më të lirë. Natyrisht, ETEAM SH.P.K. e kupton se vetëm çmimi më i lirë nuk mjafton për rekomandim për kontratë dhe se oferta duhet të plotësojë të gjitha kërkesat e Dosjes së Tenderit. Mirëpo, pikërisht për këtë arsye, nëse ekziston vetëm një paqartësi dokumentare e cila mund të verifikohet objektivisht dhe e cila nuk ndryshon përmbajtjen materiale të ofertës, interesi i prokurimit publik dhe qëllimi i LPP-së kërkojnë që të sqarohet gjendja reale dhe jo që operatori ekonomik me çmimin më të ulët të eliminohet pa një verifikim të plotë të këtij fakti.

Neni 1 i LPP-së përcakton se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë. Në këtë kuptim, vlerësimi i një oferte duhet të bëhet në mënyrë të tillë që të sigurohet jo vetëm respektimi formal i dokumentacionit, por edhe identifikimi i ofertës së përgjegjshme që realisht i përmbush kërkesat e AK-së.

Gjithashtu është tejet e çuditshme dhe kërkon sqarim edhe fakti se AK, për të njëjtën çështje, përkatësisht lidhur me dokumentacionin e stafit, na ka kërkuar sqarime në dy aktivitete të tjera të prokurimit të zhvilluara paraprakisht, konkretisht në aktivitetin e prokurimit **“Ndërtimi dhe rregullimi i degëzimit të rrugës Duka Mishi” në Mitrovicën Veriore**, me Nr. të Prokurimit **647-26-4780-5-2-1**, si dhe në aktivitetin e prokurimit **“Rregullimi i rrugës Nezir Zasella” në Mitrovicën Veriore**, me Nr. të Prokurimit **647-26-4540-5-2-1**.

PROVË: Sqarimet e ofruara nga ETEAM SH.P.K. lidhur me këto dy aktivitete të prokurimit.

Në të dy këto aktivitete të prokurimit, AK është mjaftuar me sqarimet e ofruara nga ETEAM SH.P.K. lidhur me çështjen e stafit, ndërsa nëpërmjet Njoftimeve mbi Vendimin e AK-së për këto aktivitete, oferta e ETEAM SH.P.K. është shpallur e pasuksesshme për arsye se oferta jonë ka qenë me çmim më të lartë se oferta e operatorit ekonomik të rekomanduar për kontratë, dhe jo për shkak se sqarimet lidhur me stafin nuk janë pranuar apo se ETEAM SH.P.K. nuk ka përmbushur kriterin përkatës të stafit.

PROVË: Njoftimi mbi Vendimin e AK-së lidhur me aktivitetin e prokurimit nr. 647-26-4780-5-2-1 dhe Njoftimi mbi Vendimin e AK-së lidhur me aktivitetin e prokurimit nr. 647-26-4540-5-2-1.

Kjo praktikë e mëparshme e të njëjtit Autoritet Kontraktues është një rrethanë jashtëzakonisht relevante për rastin konkret. Natyrisht, ETEAM SH.P.K. nuk pretendon se vendimet e mëparshme e detyrojnë automatikisht AK-në që të marrë të njëjtin vendim, mirëpo kur kemi të bëjmë me të njëjtin operator ekonomik, të njëjtin Autoritet Kontraktues dhe çështje të njëjta ose të ngjashme lidhur me dokumentimin e stafit, është e arsyeshme dhe e drejtë që AK të japë një trajtim konsistent dhe transparent dhe, nëse tani ka zgjedhur një qasje tjetër, të japë arsyetim të qartë se përse në këtë aktivitet të prokurimit ka vepruar ndryshe.

Në të kundërtën, krijohet një situatë ku për rrethana të njëjta ose të ngjashme, i njëjti Autoritet Kontraktues ka përdorur mekanizmin e sqarimit në rastet paraprake, ndërsa në këtë aktivitet ka zgjedhur menjëherë eliminimin e operatorit ekonomik, ndonëse edhe në këtë rast ekzistenca e stafit mund të verifikohet përmes dokumenteve të ATK-së dhe kontratave të punës.

Prandaj, duke i marrë parasysh të gjitha rrethanat e lartcekura, është e qartë se ETEAM SH.P.K. e ka përmbushur në substancë kërkesën e AK-së lidhur me minimumin prej tetë (8) punëtorëve. Mangësitë e pretenduara nga AK kanë të bëjnë me dokumentimin e këtij kapaciteti dhe jo me mungesën faktike të tij. Për më tepër, ekzistenca e stafit përkatës para afatit të ofertimit mund të verifikohet në mënyrë objektive përmes Listës së të Punësuarve të ATK-së dhe kontratave të punës.

Në këto rrethana, AK ka pasur mundësi dhe bazë ligjore që, në pajtim me nenin 72 të LPP-së, të kërkojë nga ETEAM SH.P.K. sqarime ose dokumentacion shtesë për të eliminuar çdo paqartësi eventuale. Kjo do të ishte veçanërisht e arsyeshme duke pasur parasysh se bëhet fjalë për një ofertë me çmimin më të ulët.

Për këtë arsye, konsiderojmë se konstatimi i AK-së se ETEAM SH.P.K. ka ofruar vetëm pesë (5) punëtorë teknikë nga tetë (8) të kërkuar është i gabuar dhe i pabazuar në gjendjen reale të dokumentacionit të ofruar.

Prandaj, AK duhet të aprovoj këtë Kërkesë për Rishqyrtim, ndërsa aktivitetin e prokurimit ta kthej në Rishqyrtim, të kërkoj sqarime eventuale nga ne si OE i përgjegjshëm me çmimin më të lirë dhe të na rekomandoj për kontratë për shkak se jemi oferta e përgjegjshme me çmimin më të lirë.

Pretendimi 3: GOE i rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm

Nëpërmjet Njoftimit mbi Vendimin e AK-së të datës 13.08.2026, AK ka rekomanduar për kontratë GOE GEB SH.P.K. & HARST Group SH.P.K. Pas qasjes në ofertën e këtij GOE dhe analizimit të dokumentacionit të dorëzuar, vlerësojmë se i njëjti nuk i ka përmbushur në tërësi kërkesat e Dosjes së Tenderit dhe, rrjedhimisht, nuk është dashur të konsiderohet si GOE i përgjegjshëm.

Kjo për faktin se, nga dokumentacioni i ofertës, rezultojnë paqartësi serioze lidhur me stafin kyç të propozuar, ndërsa njëkohësisht nuk është dëshmuar përmbushja e kërkesës lidhur me posedimin e një “Pompë e ujit 3hp, diesel”.

1. Kontratat e stafit kyç

GOE i rekomanduar, për z. Trimor Gjokokaj, Master i Shkencave në Inxhinieri të Ndërtimit – Konstruktiv, ka paraqitur kontratë pune me angazhim prej 20 orësh në javë dhe pagë mujore bruto prej vetëm 100 euro, ndërsa për z. Ekrem Sallahaj, Inxhinier i Diplomuar i Ndërtimtarisë – Konstruktiv, ka paraqitur kontratë me pagë mujore bruto prej vetëm 200 euro.

Duke pasur parasysh se këta persona janë paraqitur si staf profesional/staf kyç për realizimin e kontratës, këto kontrata krijojnë paqartësi serioze lidhur me angazhimin dhe disponueshmërinë reale të tyre për realizimin e kontratës. Për këtë arsye, AK ka qenë e obliguar të verifikojë nëse këto kontrata dhe niveli i angazhimit të përcaktuar në to përputhen me kërkesat e Dosjes së Tenderit dhe nëse dëshmojnë realisht se stafi kyç do të jetë në dispozicion për realizimin e kontratës.

Pra, nuk pretendojmë se vetëm shuma e pagës, e marrë e shkëputur, e bën kontratën të pavlefshme, por se dokumentacioni i paraqitur krijon një paqartësi të arsyeshme dhe relevante që AK është dashur ta shqyrtojë dhe verifikojë para se ta konsiderojë këtë kërkesë të përmbushur. Gjithashtu meqë këto kontrata janë paraqitur si të lidhura shumë më herët, pra 15.04.2025 dhe 22.01.2026. Përveç tjerash, AK bazuar në nenin 52.7 të LPP-së ka diskrecion që të kryej kontrole mbi secilin dokument të ofruar nga OE-të, andaj kështu do të duhej të vepronte edhe në këtë rast, pra fillimisht të sigurohet që këto kontrata janë reale, e pastaj edhe të kërkoj sqarime se si ky staf do të kryej punë për 100, përkatësisht 200 euro pagë mujore.

2. Mosdëshmimi i posedimit të “Pompë e ujit 3hp, diesel”

Në Dosjen e Tenderit, AK ka kërkuar shprehimisht që operatorët ekonomikë të disponojnë edhe me një “Pompë e ujit 3hp, diesel”.

Për të dëshmuar këtë kërkesë, GOE i rekomanduar ka dorëzuar një faturë për “Pompë uji GWP302, pompë uji me karburant 80mm”, me shifër 6925582100402. Megjithatë, nga kjo faturë nuk rezultojnë karakteristikat teknike thelbësore të kërkuara nga AK, përkatësisht fuqia prej 3hp dhe fakti se pajisja është me motor diesel.

Rrjedhimisht, vetëm fakti se në faturë përmendet një “pompë uji me karburant” nuk dëshmon se pajisja i plotëson specifikat e kërkuara në Dosjen e Tenderit. Përmbushja e kërkesës duhet të jetë e verifikueshme nga dokumentacioni i ofertës, ndërsa në rastin konkret nuk mund të konstatohet në mënyrë të qartë se pajisja posedon pikërisht fuqinë 3hp dhe motorin diesel.

Duhet theksuar se kjo nuk është një mangësi e parëndësishme, pasi bëhet fjalë pikërisht për karakteristikat teknike që AK i ka përcaktuar si pjesë të kërkesës së saj. Nëse AK ka konsideruar se dokumentacioni i paraqitur nuk ishte i mjaftueshëm, ka pasur mundësi të kërkojë sqarime për të verifikuar përputhshmërinë e pajisjes, mirëpo pa një dëshmi të tillë, nuk ka pasur bazë për të konstatuar se kërkesa është përmbushur.

Kujtojmë se në një aktivitet tjetër të prokurimit të inicuar nga AK Komuna e Mitrovicës së Veriut, me titull: *“Ndërtimi i rruges, parkingut dhe krijimi i sipërfaqeve të gjelberuara në rrugën Vasilije Ostrovski” në Mitrovicën Veriore* me nr. të prokurimit: “647-26-2891-5-2-1”, ekspertja shqyrtuese lidhur me pretendimin tonë të ngjashëm, përkatësisht specifikën

“3HP, diesel” të cilën AK e konsideronte të parëndësishme, ka rekomanduar që AK duhet të kërkoj sqarime shtesë lidhur me këtë çështje.

PROVË: Shih raportin e ekspertizës në lëndën 2026/0491.

Për rrjedhojë, vlerësojmë se GOE GEB SH.P.K. & HARST Group SH.P.K. nuk ka dëshmuar përmbushjen e kërkesave të Dosjes së Tenderit, dhe si i tillë është dashur të eliminohet.

Përfundimisht eliminimi i ofertës së “ETEA” SH.P.K. është bazuar në një premisë juridike të pasaktë lidhur me fushëveprimin e nenit 72 të LPP-së dhe të nenit 38.3 të RrPP-së, duke rezultuar në mos ushtrim të një kompetence që ligji ia beson AK-së. Kjo për faktin se kapaciteti teknik i kërkuar ka ekzistuar para skadimit të afatit për dorëzimin e ofertave, është objektivisht i verifikueshëm dhe nuk është kontestuar nga AK, prandaj eliminimi bie ndesh me nenin 59, paragrafi 4 të LPP-së.

Komisioni i Vlerësimit ka bërë shkelje të Nenit 59 paragrafi 1 të LPP-së, pasi të njëjtit janë të obliguar që të vlerësojë dhe krahasojë tenderët e përgjegjshëm sipas kriterëve për dhënien e kontratës të përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe Dosjen e Tenderit. Bazuar në nenin 27, paragrafi 1, lidhur me paragrafin 3 të RrPP-së në mënyrë shumë të qartë thuhet se: *“Nëse kriteri “tenderi i përgjegjshëm me çmimin më të ulët” është kriteri i vetëm, kontrata do të jepet për tenderin me çmim më të ultë që përmbushë kërkesat e specifikuar. Nëse kriteri është ‘tenderi ekonomikisht më i favorshëm’, kontrata duhet ti jepet tenderit i cili më së miri përmbushë kriteret relevante”*. Përkundër se ne plotësojmë të gjitha kërkesat dhe jemi OE më i lirë, AK na ka shpallë OE të papërgjegjshëm, duke rekomanduar për kontratë një GOE i cili është me çmim më të shtrenjtë dhe qartazi nuk ka përmbushur kërkesat e dosjes së tenderit dhe si i tillë është i papërgjegjshëm.

Komisioni i Vlerësimit ka shkelur nenin 72 të LPP-së kur nuk ka kërkuar sqarime nga OE ETEAM SH.P.K., përkundër që janë plotësuar të gjitha parakushtet për një kërkesë të tillë, ndërsa në vend të zbatimit të kësaj dispozite, rekomandohet për kontratë një GOE i papërgjegjshëm.

Gjithashtu Komisioni i Vlerësimit nuk ka respektuar nenin 40 të RrPP-së, konkretisht paragrafin 1, i cili kërkon që ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve të bëhet në pajtueshmëri me parimet themelore të përcaktuara me LPP. Pastaj paragrafin 13 i cili saktëson se: *“Komisioni vlerësues do t'i vlerësojë dhe krahasojë tenderët e përgjegjshëm sipas kriterëve për dhënien e kontratës të përcaktuara në njoftimin e kontratës / dosjen e tenderit*.

Komisioni i Vlerësimit ka shkelur në mënyrë flagrante nenin 40, paragrafi 6 i RrPP-së, kur ka rekomanduar për kontratë GOE-në GEB SH.P.K. & HARST Group SH.P.K. Bazuar në këtë dispozitë, ku në mënyrë të qartë potencohet se: *“Tenderi do të konsiderohet i përgjegjshëm kur:*

a. është në pajtueshmëri nga aspekti administrativ me kërkesat formale të dosjes së tenderit;

b. është në pajtueshmëri në termet teknike me përshkrimin, kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në dosje të tenderit;

c. është dorëzuar nga Operatori ekonomik që përmbush kriteret e përzgjedhjes të përcaktuara në dosje të tenderit”.

Komisioni i Vlerësimit nuk ka arritur të zbatoj as nenin 52.7 të LPP-së për të dëshmuar kapacitetin profesional të GOE të rekomanduar, konkretisht lidhur me kontratat e punës me çmim jashtëzakonisht të ulët.

Gjithashtu Komisioni i Vlerësimit të AK-së ka shkelë edhe nenin 7 të LPP-së, ku në paragrafin 1 të nenit 7 parashihet qartë se: *“Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese dhe do te veproje ne mënyrë transparente. Po ashtu paragrafi 6 i nenit 7 të LPP-së parasheh që: “Gjatë udhëheqjes së aktiviteteve të prokurimit, të gjitha autoritetet kontraktuese do të sigurojnë: (vi) që tenderi i zgjedhur të përputhet me të gjitha aspektet përmbajtësore të kushteve, kriterëve dhe specifikimeve përkatëse”, mirëpo AK nuk i është përmbajtur as kësaj dispozite ligjore.*

Përtej këtyre, AK nuk e ka pasur në konsideratë edhe nenin 1 të LPP-së, pasi që qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Andaj, mbi bazën e asaj që u theksua më lartë, Organit Shqyrtues të Prokurimit i propozojmë që të marrë këtë:

V E N D I M

- I.** **APROVOHET** si e bazuar Ankesa e OE “ETEAM SH.P.K”
- II.** **ANULOHET** Njoftimi mbi Vendimin e AK-së i datës 21.08.2026, ashtu që lënda kthehet në **RIVLERËSIM** duke u rekomanduar për kontratë OE ETEAM SH.P.K si OE i përgjegjshëm dhe me çmimin më të lirë.
- III.** **DETYROHET** AK që ankuesit OE “ETEAM SH.P.K.” t’ia mbulojë shpenzimet e procedurës.
- IV.** Meqë ankesa ishte e bazuar, OE “ETEAM SH.P.K.” i kthehen mjetet e depozituara në emër të ankesës.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t’i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

ETEAM SH.P.K., deri në këtë fazë të procedurës i janë shkaktuar dëme të konsiderueshme të cilat konsistojnë në përgatitjen e aplikimit për tender, përgatitjen e mjeteve juridike për apelimin e vendimeve të kundërligjshme të AK-së. Andaj, në rast se OSHP nuk e kthen ligjshmërinë në këtë aktivitet, dëmet do të marrin dimension

10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

- a) një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
- b) një kopje të publikimit për “Njoftimin e Dhënies së Kontratës” apo “Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimit për Anulim”.*
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,*
- e) bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontekstit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se,*
- f) Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe*
- g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.*

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*